

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6198
E mërkurë, 23 dhjetor 2020
çmimi 0.40 €

Dënohet sulmi ndaj gazetarit Valon Sylaj



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

USHTRUESJA E DETYRËS E PRESIDENTIT, VJOSA OSMANI, KA NISUR KONSULTIMET ME PËRFAQËSUESIT E PARTIVE POLITIKE PËR DATËN E MBAJTJES SË ZGJEDHJEVE TË REJA

PARTITË PROPOZOJNË FUNDIN E JANARIT OSE FILLIMIN E SHKURTIT PËR MBAJTJEN E ZGJEDHJEVE

FAQE 4-5



Ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, ka takuar të martën përfaqësuesit e partive politike, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese që qeveria Hoti është zgjedhur në mënyrë jokushtetuese.

Osmani me përfaqësuesit e LV-së, të LDK-së, të PDK-së dhe të AAK-së ka diskutuar për datën e mbajtjes së zgjedhjeve të reja. Përfaqësuesi i LDK-së, Arban Abrashi, ka thënë se 7 shkurti


është datë e mundshme për mbajtjen e zgjedhjeve, ndërkaq përfaqësuesi i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se fundi i janarit është datë e përshtatshme për mbajtjen e zgjedhjeve

ZGJATET PËR NJË ORË ORARI I LËVIZJES

FAQE 3

Qeveria e Kosovës ka publikuar të martën masat e reja kundër Covidit. Sipas këtyre masave, nuk do të hiqet ora policore, por lëvizja e qytetarëve nëpër të gjitha komunat e Kosovës ndalohet nga ora 20:00 deri në orën

5:00 të mëngjesit. Me masat e reja është zgjatur edhe orari i veprimtarisë së lokaleve të gastronomisë. Operatorët ekonomikë lejohen të punojnë nga ora 5:00 deri në orën 20:00



EKONOMI



SHKALLA E PUNËSIMIT
PËR TREMUJORIN E DYTË
24.1 PËR QIND, PAPUNËSIA
27.2 PËR QIND F. 8

OAK-U KËRKON KONTROLLE
MË TË SHPESHTA NGA
INSPEKTORATI I TREGUT F. 8

SPORT

BASKETBOLLI SJELL NDESHJE
INTERESANTE NË MESJAVË F. 12



RËNIA EKONOMIKE NË KOSOVË PRITET TË JETË 7.2 PËR QIND

FAQE 9

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kongresi amerikan miraton një paketë ndihme prej 900 miliardë dollarësh



WASHINGTON, 22 DHJETOR - Kongresi amerikan ka miratuar një projektligj që përfshin një paketë ndihme prej 900 miliardë dollarësh për t'i përballuar efektet e koronavirusit si dhe një buxhet prej 1.4 trilion dollarësh për këtë vit financiar. Si Dhoma e Përfaqësuesve ashtu edhe Senati e miratuan projektligjin me shumicë dërrmuese të hënën në mbrëmje. Ligjvënësit, të cilët kishin vetëm disa orë në dispozicion për ta shqyrtuar projektligjin prej 5 mijë faqesh, përballëshin me një afat që skadonte në mesnatë, pas të cilit fondet për qeverinë mbaronin. Presidenti Donald Trump pritet ta nënshkruajë projektligjin në ditët në vijim.

Kjo masë legislative vjen pas disa javë negociatash gjatë të cilave udhëheqësit demokratë e republikanë u përfshinë në debate rreth sasisë së ndihmës qeveritare për koronavirusin si dhe nëse vëmendja duhej përqendruar në çështje të tilla si asistencë në rast papunësie, apo mbajtja e ekonomisë hapur. Ky zhvillim vjen në kohën kur numri i infeksioneve me Covid-19 është rritur. Sipas universitetit "Johns Hopkins", që nga fillimi i pandemisë Shtetet e Bashkuara regjistrojnë më shumë se 18 milionë raste të konfirmuara me Covid-19, duke shtuar më shumë se 200 mijë raste të reja në ditë, ndërsa numri i vdekjeve ka arritur në më shumë se 319 mijë.

Shqipëria dhe ShBA-ja, marrëveshje për ekstradim

TIRANË, 22 DHJETOR - Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës nënshkruan të martën marrëveshjen për ekstradim, e cila zëvendëson traktatin e vitit 1933, të firmosur nga Faik Konica. Marrëveshja u nënshkrua nga ambasadorja amerikane Yuri Kim, dhe ministrja e Drejtësisë e Shqipërisë, Etilda Gjonaj. Ambasadorja Kim tha se kjo marrëveshje ofron siguri se do të ketë ndëshkueshmëri ndaj krimin ndërkombëtar dhe se asnjëri nga vendet nuk do të bëhet strehë e atyre që i ikin drejtësisë. "Ky traktat e modernizon nismën mes ShBA-së dhe Shqipërisë, që është nënshkruar fillimisht 87 vjet më parë. Ky traktat ekstradimi siguron një kornizë moderne që ShBA-ja dhe Shqipëria të përballen me sfidat e krimin ndërkombëtar. Ky traktat siguron një tjetër armë të fuqishme për t'i dhënë

fund pandëshkueshmërisë së kriminelëve. Nuk do të ketë strehë të sigurt këtu, ose në Shtetet e Bashkuara, për të arratisurit që përpiqen t'i shpëtojnë drejtësisë. ShBA-ja do të vazhdojë të qëndrojë përkrah Shqipërisë për ta çuar përpara sfidën për drejtësi", shtoi Kim. Ministrja Gjonaj tha se nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje është zotim i Qeverisë së Shqipërisë për të forcuar shtetin e së drejtës. "Akti që formalizojmë sot përmes këtij nënshkrimi, është shenjë e qartë e vullnetit të palëkundur të Qeverisë shqiptare në drejtim të zbatimit të ligjit dhe forcimit të shtetit të së drejtës, por edhe provë e mbështetjes së pakursyer të mikut dhe aleatit tonë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në realizimin e këtij objekti të përbashkët. Marrëveshja shërben si një sinjal i qartë dhe i vendosur



ndaj të gjithë shkelësve të ligjit, se askush nuk do të gjejë asnjë strehë për t'iu shmangur zbatimit të ligjit penal në ShBA apo në Shqipëri", u shpreh Gjonaj. Sipas marrëveshjes së re, do të realizohet zgjerimi dhe

përditësimi i kategorive të veprave penale, për të cilat mund të kërkohet ekstradimi nga palët, mbi bazën e parimit të kriminalitetit të dyfishtë. Këtu përfshihen veprat penale më të reja, si ato me karakter

financiar, tatimor dhe doganor; korrupsioni, veprat mjedisore, veprat në fushën informatike e çdo veprë që dënohet me heqje të lirisë për një periudhë maksimale prej më shumë se një viti ose për një dënim më të rëndë.

Slovenia fillon testimin masiv për Covid-19




LUBJANË, 22 DHJETOR - Slovenia ka filluar testimin masiv kundër koronavirusit përmes një fushate që synon një të katërtën e popullsisë së saj dymilionëshe. Faza e parë do të zgjasë deri të enjten dhe është në dispozicion për këdo që dëshiron të testohet. Një tjetër fazë do të ndodhë pas Krishtlindjes, duke u përqendruar në punëtorët siç janë: mësuesit, ushtarët dhe

oficerët e policisë. Mbi njëqind njerëz shkuan në sheshin qendror të kryeqytetit Lubjanë, në një nga disa pikat në 13 qytete ku do të kryhet testimi. Sekretarja e ministrisë së Shëndetësisë në Sloveni, Marija Magajne, tha të hënën se programi synon "ta frenojë përhapjen e koronavirusit, uljen e numrit të njerëzve të shtruar në spital si dhe vdekjet".

Ajo ka thënë se rezultatet e testimit do të kumtohen përmes mesazhit në telefon brenda 15 minutash së bashku me udhëzimet për ata që janë pozitivë. Slovenia dhe disa vende në rajon janë përballur me nivele të larta të të infektuarve në muajt e fundit. Që nga muaji mars më shumë se 2 400 slovenë kanë vdekur dhe mbi 107 000 janë infektuar me koronavirus.

Zgjatet për një orë orari i lëvizjes

Qeveria e Kosovës ka publikuar të martën masat e reja kundër Covidit. Sipas këtyre masave, nuk do të hiqet ora policore, por lëvizja e qytetarëve nëpër të gjitha komunat e Kosovës ndalohet nga ora 20:00 deri në orën 5:00 të mëngjesit. Me masat e reja është zgjatur edhe orari i veprimtarisë së lokaleve të gastronomisë. Operatorët ekonomikë lejohen të punojnë nga ora 5:00 deri në orën 20:00



EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Qeveria e Kosovës ka publikuar masat e reja kundër Covidit, të cilat pritet të hyjnë në fuqi të mërkurën. Sipas këtyre masave, nuk do të hiqet ora policore, por lëvizja e qytetarëve nëpër të gjitha komunat e Kosovës ndalohet nga ora 20:00 deri në orën 5:00 të mëngjesit. Në bazë të këtyre masave nuk është hequr kategorizimi i komunave. Orari i lëvizjes së qytetarëve si dhe orari i veprimtarisë së lokaleve të gastronomisë është zgjatur. "Në zonën me operatorët ekonomikë lejohen të punojnë nga 5:00-20:00, qendrat tregtare lejohen të punojnë nga 5:00-20:00, shërbimet e hotelierisë dhe gastronomisë lejohen të punojnë nga 05:00-20:00, ndërkaq pas orës 20:00 punojnë me shërbim 'merr me vete dhe 'porosi me dërgesë', transporti publik lejohet të punojë duke shfrytëzuar deri në 50 për qind të kapaciteteve, duke respektuar 'Manualin për

mbrojtjen nga përhapja e Covid-19", thuhet në vendimin e qeverisë.

Po sipas këtij vendimi, personave mbi moshën 65 vjeç iu lejohet dalja jashtë shtëpisë vetëm gjatë orarit 6:00-10:00 dhe 16:00-19:00, ndërkaq jashtë këtij orari mund të dalin vetëm për nevoja emergjente dhe shëndetësore duke e dëshmuar me dokument përkatës nevojën për dalje jashtë këtij orari tek organi kompetent kontrollues.

Të gjithë qytetarët e Kosovës (përfshirë edhe ata me vendbanim në një shtet tjetër), gjatë hyrjes në Kosovë duhet të paraqesin vërtetim për test RT-PCR negativ të bërë më së largu 72 orë para hyrjes në Kosovë, në të kundërtën duhet të vetizolohen për 7 ditë.

Organizimi i procesit arsimor

Procesi arsimor në institucionet parauniversitare, publike dhe private, për gjysmëvjetorin e dytë fillon më 18 janar 2021 dhe

organizohet sipas planit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Procesi arsimor në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, publik dhe privat, organizohet sipas planprogramit të institucioneve përkatëse në formën online, përveç provimeve, punës praktike dhe laboratorike që duhet të organizohet në përputhje me

rekomandimet e IKShPK-së dhe MSh-së. Veprimtaria e çerdheve publike dhe private vazhdon sipas vlerësimit dhe mbikëqyrjes nga autoritetet komunale, bazuar në "Manualin për mbrojtje nga përhapja e Covid-19", përfshirë matjen e temperaturës së fëmijëve dhe stafit në baza ditore gjatë hyrjes në objekte. Konviktet dhe mensat punojnë duke

respektuar manualin për mbrojtje dhe përhapjen nga Covid-19. Të gjitha institucioneve arsimore në të gjitha nivelet e arsimit, publik dhe privat, iu ndalohet organizimi i aktiviteteve jashtë mësimore, siç janë ekskursionet, shëtitjet grupore, ahengjet e ndryshme të stafit mësimor dhe nxënësve-studentëve dhe të ngjashme.

Mbi 70 mijë njerëz erdhën në Kosovë në fundjavë

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Gjatë fundjavës mbi 70 mijë persona kanë hyrë në territorin e Kosovës, nga kufijtë tokësorë dhe ajrorë, thuhet në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë" nga Policia e Kosovës.


Sipas masave në fuqi, shtetasit e Kosovës që jetojnë jashtë vendit nuk kanë nevojë të paraqesin testin PCR për koronavirus dhe as të izolohen. Paraqitja e testit vlen vetëm për personat që nuk kanë vendbanim në Kosovë dhe për ata që vijnë nga shtetet me rrezik të lartë të përhapjes së koronavirusit, sipas klasifikimit që bën Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC).

Megjithatë, institucionet e Kosovës i bëjnë thirrje diasporës që t'i respektojë masat mbrojtëse për ta parandaluar përhapjen e koronavirusit.

Ministri i Shëndetësisë i Kosovës, Armend Zemaj, tha se me ardhjen

e diasporës, nevojitet kujdes i shtuar dhe që institucionet ta mbikëqyrin zbatimin e masave në mënyrë rigoroze edhe në pikat kufitare, por edhe në brendi të territorit të shtetit. "Në kuadër të koordinimit dhe aktiviteteve, nuk guxon dhe nuk guxojmë që të na dështojë asnjë hallkë e mbikëqyrjes sepse atëherë dështojmë të gjithë për të njëjtën situatë", ka deklaruar të hënën ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj.

Infektologu Sali Ahmeti në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" thotë se duke marrë parasysh rrethanat specifike në Kosovë, me pandeminë e shkaktuar nga koronavirusi, kujdesi i qytetarëve duhet të jetë në mënyrë maksimale, pasi qytetarët nga diaspora mund të infektajnë të tjerë apo edhe anasjelltas dhe më pas ta bartin virusin edhe në shtetet ku jetojnë. "Çdo lëvizje e qytetarëve dhe çdo



tubim jashtë normave të parapara bartë në vete një rrezik për bartjen e infeksioneve", thekson Ahmeti. Disa shtete të Evropës, si

Gjermania, Holanda, Italia, Britania e Madhe dhe Franca, ku jetojnë edhe një pjesë e madhe e diasporës së Kosovës, kanë

paralajmëruar izolim gjatë festës së Krishtlindjes dhe Vitit të Ri, në përpjekje për ta frenuar përhapjen e mëtejme të koronavirusit të ri.

USHTRUESJA E DETYRËS E PRESIDENTIT, VJOSA OSMANI, KA NISUR KONSULTIMET ME PËRFAQËSUESIT E PARTIVE POLITIKE PËR DATËN E MBAJTJES SË ZGJEDHJEVE TË REJA

PARTITË PROPOZOJNË FUNDIN E JANARIT OSE FILLIMIN E SHKURTIT PËR MBAJTJEN E ZGJEDHJEVE

Ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, ka takuar të martën përfaqësuesit e partive politike, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese që qeveria Hoti është zgjedhur në mënyrë jokushtetuese. Osmani me përfaqësuesit e LV-së, të LDK-së, të PDK-së dhe të AAK-së ka diskutuar për datën e mbajtjes së zgjedhjeve të reja. Përfaqësuesi i LDK-së, Arban Abrashi, ka thënë se 7 shkurti është datë e mundshme për mbajtjen e zgjedhjeve, ndërkaq përfaqësuesi i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se fundi i janarit është datë e përshtatshme për mbajtjen e zgjedhjeve



është bërë me dije nga Presidenca se sot (e mërkurë) Osmani do t'i takojë edhe përfaqësuesit e partive të tjera politike. Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë u ka bërë thirrje të gjitha partive politike dhe institucioneve në Kosovë që t'i respektojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese. "Shtetet e Bashkuara u bëjnë thirrje të

gjitha partive politike dhe institucioneve në Kosovë t'i respektojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe të sigurojnë që qytetarët e Kosovës ta kenë mundësinë t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre përmes zgjedhjeve të lira, të drejta dhe paqësore", thuhet në deklaratën e Ambasadës së ShBA-së në Kosovë.

Tashmë, për shkak të situatës së re të krijuar, votimi i Projektligjit për buxhetin e vitit 2021 ka mbetur peng. Ky vendim e çon Kosovën në zgjedhje të parakohshme, aktualisht pa mjete për realizimin e tyre. Projektligji për ndarje buxhetore është sjell në Kuvend nga qeveria dhe ndodhet në shqyrtim të Komisionit për Buxhet dhe Transfere në Kuvendin e Kosovës. Projektligji për buxhetin për vitin e ardhshëm është projektuar në vlerë prej 2.4 miliardë eurosh. Në bazë të procedurave ligjore, afati përfundimtar kur duhet të miratohet Projektbuxheti për vitin 2021 nga deputetët e Kuvendit të Kosovës është data 31 dhjetor.

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, i ka bërë thirrje Kuvendit që të mos shpërndalet pa miratuar buxheti për vitin 2021. Hoti ka bërë me dije se ka

kërkuar nga grupet parlamentare që të organizojnë një seancë të veçantë për këtë çështje. Ai ka thënë se ka një disponim të mirë që të kryhet çështja e buxhetit.

Në anën tjetër, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kanë thënë se aktualisht nuk ka mjete buxhetore të planifikuara për procesin zgjedhor i cili nuk është i planifikuar. Buxheti për organizimin dhe mbajtjen e procesit zgjedhor në vitin 2019 ishte rreth 6 milionë euro.

Kuti: Të kemi një qeveri të re e kompetente

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se partia e tij do që zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbahen sa më shpejt, por ka thënë se në takim me ushtruesen e detyrës së presidentit, Vjosa Osmani, nuk ka biseduar për datën e zgjedhjeve. "Ky ishte një këshillim paraprak dhe ne shprehëm interesimin tonë si subjekt politik që për zgjedhjet e ardhshme parlamentare të kemi një datë sa më të hershme", ka thënë Kurti, duke shtuar se presin ta marrin aktgjykimin e plotë të Gjykatës Kushtetuese.

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, ka takuar të martën përfaqësuesit e partive politike, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese që qeveria Hoti është zgjedhur në mënyrë jokushtetuese për shkak të votës të deputetit Etem Arifit, i cili më 3 qershor votoi për qeverinë Hoti, ndonëse kishte një dënim të formës së prerë për veprën penale "mashttrim me subvencione", prej një vit e tre muaj burgim. Ai aktualisht është në vuajtje të dënimit. "Marrë

parasysh se qeveria nuk është zgjedhur sipas Kushtetutës, atëherë presidenti i Republikës së Kosovës shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se 40 ditë nga dita e shpalljes së tyre", thuhet në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 21 dhjetor. Gjykata Kushtetuese ka bërë të qartë se qeveria Hoti do të mbetet në detyrë deri në zgjedhjen e një ekzekutivi të ri. U. d. presidentja Osmani të martën ka takuar përfaqësuesit e LV-së, të LDK-së, të PDK-së dhe të AAK-së me të cilët ka diskutuar për datën e mbajtjes së zgjedhjeve të reja. Ndërkaq



Hoti: Do ta respektoj vendimin e Kushtetueses

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se e pranon vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës që konstatoi se qeveria që udhëheq ai është zgjedhur në mënyrë jokushtetuese. Ai ka thënë se do ta respektojë këtë vendim. “Është obligim kushtetues që t’i përfillim procedurat për shpalljen e zgjedhjeve brenda afatit kushtetues”, ka thënë Hoti në një konferencë për media mbajtur të martën. Ai ka thënë se do të jetë në krye të detyrës për t’u marrë me obligimet që i ka karshi qytetarëve të vendit, sidomos

për menaxhimin e situatës së pandemisë. I pyetur për kandidatin për kryeministër nga LDK-ja, Hoti ka thënë se brenda partisë ende nuk është diskutuar për këtë temë. Kryeministri në detyrë, po ashtu, komentoi funksionimin e koalicionit qeverisës, duke thënë se ka funksionuar jo në mënyrë të përkryer, por të mirë. “Sigurisht, kemi pasur plot çështje të brendshme, sfida të ndryshme të cilat i kemi tejkaluar me diskutime të brendshme, por (v.j. koalicioni) ka dhënë rezultate”, u shpreh Hoti.



“Pas kësaj mund të shpallet data e zgjedhjeve, në një hark të caktuar kohor, siç e parashihet Kushtetuta”, ka thënë ai.

Kurti ka theksuar se përmes zgjedhjeve të reja do të “restaurohet legjitimiteti i institucioneve”. “Ne jemi të interesuar që të mbahen zgjedhjet e reja dhe të parakohshme në Republikën e Kosovës meqenëse kemi humbur shumë kohë dhe na nevojitet të ecim sa më shpejt, që duke u kthyer te populli si burim i sovranitetit, ta restaurojmë legjitimitetin e institucioneve dhe të kemi një qeveri të re e kompetente, e cila e nxjerr Kosovën nga kriza e shumëfishitë”, ka deklaruar Kurti.

Abrashi: 7 shkurti, datë e mundshme për zgjedhjet

Anëtari i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arban Abrashi, ka thënë se gjatë takimit që ka zhvilluar me ushtruesen e detyrës së

presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka përmendur 7 shkurtin datë të mundshme për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. “Gjithsesi ky është takim preliminar dhe besoj që në takimet, pas aktgjykimit të plotë [të Gjykatës Kushtetuese], e caktojmë edhe më saktë datën”, ka deklaruar Abrashi pas takimit me Osmanin. Ai ka thënë se në të kaluarën LDK-ja ka kërkuar që zgjedhjet të mbahen në janar, në mënyrë që të mund të përfundojnë të gjitha procedurat zgjedhore përpara se Osmanit t’i skadojë mandati gjashtëmuor si ushtruese e detyrës së presidentit. “Ne si LDK edhe më herët kemi deklaruar se jemi të gatshëm për zgjedhje, duke parë edhe kontekstin politik, edhe rrethanat politike. Shpeshherë e kemi përmendur që zgjedhjet mund të mbahen edhe në janar në mënyrë që procesi zgjedhor, certifikimi, ankesat, të gjitha të përfundojnë në kuadër të mandatit kushtetues të ushtrueses së detyrës së presidentit. Prandaj,

të mos kalohet kjo dhe të mos kalojmë në një paqartësi kushtetuese”, ka thënë Abrashi. LDK-ja, shtoi ai, ende nuk ka diskutuar për mënyrën se si do të marrë pjesë në zgjedhje, por tha se “orientimet janë që të shkojmë vetë në zgjedhje”. Ai, po ashtu, ka thënë se LDK-ja nuk ka ende kandidat për kryeministër.

Krasniqi: Fundi i janarit, datë e përshtatshme për mbajtjen e zgjedhjeve

Deputeti i PDK-së, Memli Krasniqi, pas takimit konsultativ me u. d e presidentes Vjosa Osmani, ka thënë se fundi i janarit është datë e përshtatshme për mbajtjen e zgjedhjeve. “Ishte një takim konsultativ. Shprehja qëndrimin që ne presim që data e zgjedhjeve të shpallet sa më shpejt të jetë e mundur brenda afatit. Fundi i janarit është datë e përshtatshme. Besojmë se është e domosdoshme të mos humbet kohë pasi që edhe viti i ardhshëm po vjen me shumë pikëpyetje sa i përket

funksionimit të institucioneve dhe krizës ekonomike”, ka thënë Krasniqi.

Ndërkaq kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka mbajtur të martën konferencë për media. Gjatë kësaj konference Hoxhaj ka thënë se PDK-ja e mirëpret vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe ka kërkuar që sa më parë të shkohet në zgjedhjet e parakohshme. Hoxhaj ka thënë se nga 6 tetori i vitit 2019, qytetarët e Kosovës kanë përjetuar dy qeveritë më të dobëta në 20 vjetët e fundit, të cilat kanë prodhuar vetëm lajme negative për vendin. “Qytetarët e Kosovës, pa fajin e tyre, janë ballafaquar me një mashtrim të

madh të dalë nga 6 tetori, i cili më pas prodhoi dy qeveritë më të dobëta që ka pasur vendi ynë. Në 14 muajt e fundit qytetarët e Kosovës janë ballafaquar me zhgënjim, mashtrim, shpresë të vjedhur dhe premtime të papërmbytura”, ka thënë Hoxhaj, duke shtuar se në degradimin më të madh që i është bërë vendit gjatë kësaj periudhe, fajtorë janë vetëm dy qeveritë e fundit të udhëhequra nga Kurti dhe Hoti. Hoxhaj ka thënë se Partia Demokratike e Kosovës është e gatshme për zgjedhje dhe partia më e përgatitur, me programin më të mirë për ta nxjerrë vendin nga kriza e thellë në të cilën është futur.

Si u dërgua lënda në Kushtetuese?

Kërkesa në Kushtetuese u dërgua nga partia opozitare, Lëvizja Vetëvendosje, e cila ka kërkuar që të shpallet i pavlefshëm votimi i qeverisë së udhëhequr nga Avdullah Hoti nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Më 3 qershor për zgjedhjen e qeverisë kishte votuar edhe deputeti Etem Arifi, i cili kishte një aktgjykim të formës së prerë nga Gjykata e Apelit, vendim i cili daton më 20 gusht 2020, ku Arifi ishte dënuar me 1 vit e 3 muaj burgim për “mashtrim me subvencione”. Gjatë një seance dëgjimore, të mbajtur më 2 dhjetor nga Gjykata Kushtetuese për këtë rast, përfaqësuesi ligjor i Lëvizjes Vetëvendosje, Blerim Sallahu, pati deklaruar se Arifi kishte

gënjyer dhe ka mbajtur të fshehur faktin se ka aktgjykim të formës së prerë ndaj tij. “Prandaj, ne konsiderojmë se procedura në Kuvend më 3 qershor është e zaturuar dhe se tani duhet të shpallen zgjedhjet e jashtëzakonshme”, pati deklaruar Sallahu. Gjatë kësaj seance dëgjimore, kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, deklaroi se institucioni që ajo udhëheq nuk ka qenë në dijeni të vendimit të Gjykatës së Apelit lidhur me Etem Arifin. Ajo tregoi se në Ligjin për zgjedhjet specifikohet se asnjë person që ka dënim të plotfuqishëm në tre vjetët e fundit nuk mund të kandidojë për zgjedhje të përgjithshme.



AGK-ja dënon sulmin ndaj gazetarit Valon Syla

PRISHTINË, 22 DHJETOR (ER) - Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) ka dënuar sulmin fizik ndaj gazetarit Valon Syla. Në një video e cila ka qarkulluar në rrjetet sociale, Syla shihet duke u grushtuar nga një person i panjohur.

Në lidhje me rastin, AGK-ja ka kontaktuar Policinë e Kosovës, e cila ka konfirmuar se ka pranuar informatën për sulmin ndaj gazetarit Valon Syla. "Sot rreth orës 12:05 kemi pranuar informatën se në lagjen Pejton është sulmuar gazetari. Njëسيا policore ka arritur në vendin e

ngjarjes dhe ka kontaktuar përmes telefonit me gazetarin, i cili ka deklaruar se për momentin nuk ka nevojë për trajtim mjekësor. Jemi duke e pritur për të marrë informata të tjera", ka thënë zëdhënësi i Policisë së Kosovës për AGK-në, Baki Kelani.

AGK-ja kërkon nga organet e drejtësisë që sa më shpejt t'i hetojnë motivet e sulmit dhe ta zbardhin këtë rast, i cili në themel dëmton lirinë e shprehjes dhe medias. Secili sulm në drejtim të gazetarëve është sulm ndaj fjalës së lirë dhe demokracisë në vend.



Ngrehet aktakuzë për mbajtje të paautorizuar të armëve

PRISHTINË, 22 DHJETOR (ER) - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngrehur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, kundër katër të pandehurve me inicialet A. A., B. K., Sh. Z. dhe V. R. për veprat penale "Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve", nga neni 328 paragrafi 1 të KPRK-së si dhe "Detyrimi", mbetur në tentativë nga neni 267, paragrafi 2, lidhur me nenin 1 dhe nenin 20 të KPRK-së.

Prokuroria Speciale ka njoftuar se i pandehuri A. A., më 25.05.2010, me qëllim të kërcënimit dhe frikësimit, në hyrje të lokalit të të dëmtuarit H. K. ka vendosur dy herë radhazi granata dore dhe



bombola gazi, ku njëra granatë ka shpërthyer pas mesnate, tjera është gjetur e pashpërthyer, ndërsa më datë 07.09.2010 ka vendosur një granatë dore dhe një

bombole gazi e të cilat kanë shpërthyer, me ç'rast, për pasojë, kanë shkaktuar rrezikim të përgjithshëm për jetën e njerëzve, pasurinë e tyre si dhe janë shkaktuar

dëme materiale në muret, dyert dhe dritaret e objektit aty pranë. Me këto veprime i pandehuri i lartcekur ka kryer veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve", nga neni 328, paragrafi 1 i KPRK-së.

Të pandehurit A. A., B. K., Sh. Z. dhe V. R., më 25.05.2010 dhe më 07.09.2010, duke vepruar si anëtarë të grupit me qëllim që vetes apo personit tjetër t'i sjellin dobi pasurore të kundërligjshme, kanë kërcënuar rëndë të dëmtuarin H. K., që të veprojë në dëm të pasurisë së tij, në atë mënyrë që me datat e lartcekura i pandehuri A. A., në pronën e të dëmtuarit H. K., saktësisht në zyrat e tij në Prishtinë, ka vendosur dy

herë radhazi granata dore dhe bombola gazi, i shtyrë nga të pandehurit B. K., Sh. Z. dhe V. R., me qëllim të kërcënimit dhe frikësimit që i njëjti të tërhiqet nga prona e tij e cila gjendet në fshatin Milloshevë në sipërfaqe prej 91 hektarëve, e privatizuar nga AKP-ja, ku i dëmtuari kishte 25 për qind të sipërfaqes së përgjithshme të tokës, e që kjo përqindje është bazuar në marrëveshjen e bërë në mes të pandehurit B. K. dhe tani të dëmtuarit H. K. "Me këto veprime të pandehurit e lartcekur kanë kryer veprën penale 'Detyrimi', e mbetur në tentativë nga neni 267, paragrafi 2, lidhur me nenin 1 dhe nenin 20 të KPRK-së", është bërë me dije në njoftimin e Prokurorisë Speciale.

Osmani priti në takim lamtumirës ambasadorin e OSBE-së



PRISHTINË, 22 DHJETOR (ER) - U. d. presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani Sadriu, ka pritur të martën në takim lamtumirës ambasadorin e OSBE-së në Kosovë, Jan Braathu. Në takim u diskutua për zhvillimet e fundit aktuale politike në vend dhe e falënderoi ambasadorin Braathu si përfaqësues i

shtetit norvegjez dhe ambasador i OSBE-së. Ajo theksoi rolin e rëndësishëm të OSBE-së për mbështetjen e KQZ-së dhe të institucioneve të tjera në vend. "Misioni i OSBE-së është shumë i rëndësishëm për procesin e demokratizimit", ka thënë Osmani.

Sipas saj, cilësia e procesit zgjedhor luan rol për avancimin e demokracisë në vend. Ndërkaq ambasadori Braathu ka falënderuar Osmanin për pritjen dhe ka premtuar vazhdimin e mbështetjes së OSBE-së për institucionet e Kosovës.

Rakiqi dhe Abbotti vizitojnë komunat në veri

PRISHTINË, 22 DHJETOR (ER) - Zëvendëskryeministri dhe ministri i Vetëqeverisjes Lokale, Goran Rakiq, së bashku me ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Nicholas Abbott, vizituan Mitrovicën e Veriut dhe u takuan me udhëheqjen e re të kësaj vetëqeverisje lokale të kryesuar nga

kryetari i komunës, Milan Radojeviq. Në takim morën pjesë kryetarët e komunave të Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit dhe nënkryetarja e Komunës së Mitrovicës së Veriut, Adrijana Hoxhiq. Takimi u përqendrua në çështjet aktuale politike, projektet e ardhshme, punësimin e të rinjve dhe

rimëkëmbjen pas pandemisë. Bashkëbiseduesit patën të njëjtin mendim se në të ardhmen bashkëpunimi duhet të përmirësohet për hir të një cilësie më të mirë të jetës për qytetarët, si në komunat në veri, po ashtu edhe në të gjitha komunat në të gjithë Kosovën.



Shkon në 1 272 numri i të vdekurve nga Covidi në Kosovë

Dhjetë viktimat dhe 137 raste të reja me Covid-19 u raportuan të martën në Kosovë. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se tri viktimat u regjistruan në Prizren, dy në Prishtinë dhe nga një në Drenas, Gjilan, Obiliq, Skenderaj dhe Suharekë. Rastet e reja pozitive rezultuan nga testimi i 841 mostrave. Deri më tani në Kosovë janë 1 272 raste të vdekjes nga Covidi



Suharekë 7 raste, Vushtrri 6 raste, Malishevë 5 raste, Pejë 5 raste, Prizren 5 raste, Fushë-Kosovë 4 raste, Obiliq 4 raste, Viti 3 raste, Deçan 2 raste, Istog 2 raste, Klinë 2 raste dhe me nga 1

rast komunat Drenas, Ferizaj, Kamenicë, Lipjan, Mitrovicë, Podujevë dhe Rahovec. "IKShPK-ja edhe një herë apelon te të gjithë qytetarët që të vijnë të testohen në SARS-

CoV-2 sipas indikacioneve epidemiologjike, në të gjitha qendrat rajonale të shëndetësisë publike në Kosovë", është thënë në njoftimin e këtij instituti.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 841 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 137 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar dhjetë raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prizren tri raste (81,

65, 54 vjeç), Prishtinë dy raste (67, 63 vjeç), Drenas një rast (68 vjeç), Gjilan një rast (71 vjeç), Obiliq një rast (75 vjeç), Skenderaj një rast (49 vjeç), Suharekë një rast (69 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 49 306 raste nga 173 986 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 272 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 382 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 37 155 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 10 879.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 59 raste, Gjakovë 19 raste, Gjilan 7 raste,

ShBA-ja dhuron dy laparoskopë modernë për QKUK-në



PRISHTINË, 22 DHJETOR (ER) - Ambasada Amerikane në Prishtinë, përmes Komandës Evropiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në kuadër të programit për asistencë humanitare, i ka dhuruar dy laparoskopë me pajisje përcjellëse Kirurgjisë Abdominale në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Këta laparoskopë janë të teknologjisë së fundit dhe janë të vetmit që janë në përdorim në vendet e Ballkanit.

Pajisjet kapin vlerën e më shumë se 239 mijë eurove.

Donacionin e dorëzoi major Courtney Olson, shefe e Zyrës për Mbrojtje dhe Bashkëpunim në kuadër të Ambasadës Amerikane, e cila tha se donacioni është dhuruar pas kërkesave që kanë bërë institucionet shëndetësore.

Valbon Krasniqi, ushtrues i detyrës i drejtorit të përgjithshëm në ShSKUK, ka falënderuar Komandën Evropiane dhe Shtetet e Bashkuara për donacionin, duke siguruar se këto pajisje do të përdoren për pacientët që kanë nevojë për intervenime

kirurgjike.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se ky është donacioni i radhës në kuadër të donacioneve të shumta që kanë bërë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ferat Sallahu, drejtor i Klinikës së Kirurgjisë, ka thënë se mjekët e kësaj klinike janë të përgatitur për të punuar me këta laparoskopë dhe se me ta do të lehtësohet puna e stafit mjekësor. Në kuadër të këtij projekti para disa jave është dhuruar një CT modern për Spitalin e Përgjithshëm në Gjakovë.

Prizreni fillon realizimin e testeve të shpejta antigjenë për Covid-19

PRIZREN, 22 DHJETOR (ER) - Për herë të parë në nivel të Republikës së Kosovës, nga dita e martë Komuna e Prizrenit ka filluar realizimin e testeve të shpejta (rapide) antigjenë për Covid-19 në shëndetësinë primare. Qytetarët e Komunës së Prizrenit tanimë do të mund t'i kryejnë këto teste në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Bajram Curr, duke e marrë rezultatin me 98.8 për qind saktësi

brenda 10 minutave.

Po ashtu, një ekip tjetër lëvizës përmes "kujdesit shtëpiak" të ofruar nga komuna, do t'i realizojë këto teste të shtëpitë e pacientëve që nuk mund të shkojnë në qendrat e lartcekura të mjekësisë familjare. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka thënë se ndihet i lumtur që përveç këtyre testeve, shëndetësia primare e Komunës së Prizrenit, tanimë ka kompletuar pakon e shërbimeve për Covid-19, duke

i realizuar testet e D-Dimer-it, rëntgenin e mushkërive, analizat e tjera të nevojshme dhe testet serologjike.

Po ashtu, Haskuka shpreson që Kosova të mos hyjë në valën e tretë të pandemisë por, nëse ndodh një gjë e tillë, Komuna e Prizrenit tani është gati për t'u përballur me të. Nga ana tjetër, drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë, Narqize Arënliu-Hoxhaj, ka pohuar se këto teste do të kryhen në bazë të udhëzimeve të mjekëve të institucioneve shëndetësore.



Shkalla e punësimit për tremujorin e dytë 24.1 për qind, papunësia 27.2 për qind

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Shkalla e punësimit në Anketën e Fuqisë Punëtore, për tremujorin e dytë 2020 ishte 24.1 për qind, ndërsa punësimi më i lartë ishte te meshkujt 36.2 për qind dhe te femrat 12.1 për qind, ka njoftuar Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Në raportin më të ri të kësaj agjencie për tremujorin e dytë 2020, vajzat/gratë janë të punësuara kryesisht në sektorët e arsimit, tregtisë dhe kujdesit shëndetësor, me 57.4 për qind të tyre, ndërsa djemtë/burrat janë kryesisht të punësuar në sektorët e tregtisë, ndërtimtarisë dhe prodhimit, me 42.3 për qind. "Sektorët ekonomikë, që prijnë me punësim, vazhdojnë të jenë: tregtia me 18.7 për qind, arsimi me 11.0 për qind, prodhimi me 10.8 për qind, si dhe ndërtimtaria me 8.7 për qind. Ndërsa sektorët e tjerë marrin pjesë me përqindje më

të vogël në punësim. Sa iu përket të punësuarve me kontrata, del se 42.9 për qind e personave të punësuar kanë kontratë të përhershme në punën e tyre kryesore, ndërkohë që 57.1 për qind kanë kontratë të përkohshme", është thënë në raportin e ASK-së. Sipas këtij raporti, bazuar në rezultate të anketës së fuqisë punëtore, në tremujorin e dytë 2020 shkalla e papunësisë ishte 27.2 për qind, ku më e theksuar ishte te vajzat/gratë me 31.4 për qind, krahasuar me djemtë/burrat që ishte 25.7 për qind.

Shkalla më e theksuar e papunësisë është te grupmoshat 15-24 vjeçe, me 54.1 për qind. "Sipas rezultateve të anketës së fuqisë punëtore, në tremujorin e dytë 2020 fuqia joaktive ishte mjaft e lartë, me 66.8 për qind, me fokus të veçantë te vajzat/gratë me 82.4 për qind, krahasuar me djemtë/burrat, 51.2 për qind. Ndryshe, për realizimin e anketës së fuqisë punëtore për



tremujorin e dytë 2020, aplikuar nga ana e ASK-së janë rekomandimet e Eurostatit", metodologjia dhe standardet e të harmonizuara me thuhet në raportin e ASK-së.

OAK-u kërkon kontrole më të shpeshta nga Inspektorati i Tregut

PRISHTINË, 22 DHJETOR (ER) - Asgjësimi i mallit me afat të skaduar ishte tema kryesore e takimit të realizuar ndërmjet përfaqësuesve të Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK) dhe kryeinspektorit të Tregut, Lulzim Sylja.

Kryetari i Bordit i Odës së Afarizmit të Kosovës, Skënder Krasniqi, ka kërkuar që kontrollet nga Inspektorati i Tregut të jenë më të shpeshta, pasi kohët e fundit kanë pranuar ankesa të shumta nga marketet lidhur me asgjësimin e mallit me afat të skaduar. Sipas marketeve, produktet me afat të skaduar mblidhen në depo dhe presin për rikthim te prodhuesi apo distributori.



Në momentin e kthimit të mallit, ka shumë raste kur nuk janë të pranishëm

përfaqësues, qoftë nga Inspektorati i Tregut, Inspektorati Sanitar, ATK-ja

apo edhe policia.

Krasniqi ka thënë se kthimi i produktit me afat të skaduar te prodhuesi apo distributori, lejon mundësinë e keqpërdorimit siç është ndërrimi i datës së produktit dhe rikthimi i të njëjtit në treg. Ai ka theksuar se një veprim i tillë, përveç që ndikon në shëndetin e shoqërisë sonë, njëkohësisht po vë në pozitë të palakmueshme marketet, pasi dyshimi fillestar për këto keqpërdorime nga inspektorët bie te marketet e jo te prodhuesi apo distributori.

Kryeinspektori i Tregut, Lulzim Sylja, ka përgëzuar OAK-un për punën e bërë deri më tani, duke shtuar se

bashkëpunimi është shumë i nevojshëm, në mënyrë që të krijohen kushte sa më të favorshme për të bërit biznes në vend. Ai ka kërkuar bashkëpunim edhe nga marketet që, në rast të kthimit të mallit, t'i njoftojnë paraprakisht, në mënyrë që të jenë të pranishëm në vendin e ngjarjes.

Sipas kryeinspektorit Sylja, punën e Inspektoratit të Tregut po e vështirëson mosharmonizimi me komunat pasi, sipas ligjit, inspektorët komunalë, ani pse përdorin të gjitha resurset e komunës, janë në dispozicion të Inspektoratit, mirëpo një gjë e tillë nuk po ndodh në realitet.

Nënshkruhet marrëveshje për hapjen e zyrës postare në 'Ukshin Hoti'

PRISHTINË, 22 DHJETOR (ER) - Përfaqësuesit e Postës së Kosovës kanë nënshkruar marrëveshje për hapjen e zyrës postare në kompleksin e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren. Kjo marrëveshje është nënshkruar në mes të u. d. kryeshefit ekzekutiv, Xhevdet Smakiqi, dhe rektorit të UPZ-së, prof. Ismet Temaj. "U. d. kryeshefi

Smakiqi dhe rektori prof. Temaj u zotuan për ta hapur sa më shpejt zyrën postare në hapësirat e brendshme të Universitetit të Prizrenit, e cila do të jetë në shërbim të studentëve të këtij tempulli të diturisë, që ata ta kenë mundësinë të kryejnë afër, shpejt, mirë dhe lirë të gjitha pagesat e ndryshme gjatë studimeve", është thënë në

komunikatën e Postës së Kosovës, duke u shtuar se strategjia dhe synimet e BPD-së dhe u. d. kryeshefit ekzekutiv, Xhevdet Smakiqi, janë zgjerimi i ofrimit të shërbimeve që ofron Posta e Kosovës sa më afër qytetarëve dhe institucioneve me tarifat dhe provizionet më të lira në tregun e Kosovës.



Rënia ekonomike në Kosovë pritet të jetë 7.2 për qind

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka bërë me dije të martën se, sipas parashikimeve të institucionit që drejton, ekonomia e Kosovës në vitin 2020 pritet të shënojë një rënie prej 7.2-përqindësh në terma realë, e cila, sipas tij, paraqet goditjen më të rëndë që ka pësuar ekonomia në këto 20 vjet

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, në konferencën e fundvitit me gazetarë, ka thënë se, me gjithë vështirësitë me të cilat është ballafaquar vendi, BQK-ja ka arritur t'i zbatojë objektivat e saj, duke siguruar një sistem financiar të qëndrueshëm, i cili arriti t'i përballojë zhvillimet e pafavorshme ekonomike në vend. Ai ka deklaruar se sipas parashikimeve të BQK-së, ekonomia e Kosovës në vitin 2020 pritet të shënojë një rënie prej 7.2-përqindësh në terma realë, e cila paraqet goditjen më të rëndë që ka pësuar ekonomia në këto 20 vjet. "Ndikim të rëndësishëm në rënieën e aktivitetit ekonomik në Kosovë kishin edhe masat e kufizimit të lëvizjes nga shtetet e tjera, ku nga të dhënat e regjistruara deri në shtator 2020, shpenzimet e jorezidentëve në Kosovë, pjesa më e madhe e të cilave janë nga diaspora, ishin 470 milionë euro, e cila paraqet një rënie prej 60-përqindësh në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar", u shpreh ai.

Mehmeti ka folur edhe për rolin e sistemit bankar në mbështetje të sektorit privat. "Kontributi i sektorit bankar në mbështetje të ekonomisë ishte shumë i rëndësishëm edhe në aspektin e vazhdimet të kreditimit, përkundër ngritjes së nivelit të rrezikëve me të cilat u ballafaquan

bankat. Gjatë periudhës janar - tetor 2020 vlera e kredive të reja të lëshuara nga sektori bankar ishte 1.2 miliard euro, përderisa vlera e përgjithshme e kredive aktive në sektorin bankar në tetor 2020 ishte 3.2 miliardë euro, e cila paraqet një rritje vjetore prej 7-përqindësh. Aktualisht, edhe pas ndërmarrjes së të gjithë këtyre masave jo shumë të zakonshme për një sektor bankar dhe me një ekonomi e cila gjendet në një fazë recesioni, sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë nivel të lartë të qëndrueshmërisë dhe është i gatshëm ta ushtrojë rolin e tij kyç në procesin e rimëkëmbjes ekonomike", ka thënë ai, duke shtuar se pakoja e rimëkëmbjes ekonomike e aprovuar nga Kuvendi i Kosovës parasheh një rol shumë të rëndësishëm për sektorin bankar. "Një pjesë shumë e rëndësishme e kësaj pakoje bazohet në skemat e garantimit të kredive dhe subvencionimit të normave të interesit, të cilat do ta lehtësojnë dhe përmirësojnë rrjedhën e financimit bankar drejt ekonomisë së vendit. Gjithsej mjetet e sektorit bankar kanë vazhduar trendin e rritjes edhe gjatë këtij viti, duke arritur vlerën prej 5.05 miliardë eurosh në tetor 2020, e cila paraqet një rritje vjetore prej 10.3-përqindësh", ka thënë Mehmeti.

Ai ka shtuar se sektori bankar vazhdon të gëzojë besim të lartë te publiku, besim ky i shprehur edhe me rritjen e vazhdueshme të depozitave.



"Në muajin tetor 2020 vlera e përgjithshme e depozitave ishte rreth 4.1 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8.7-përqindësh. Ritmi i rritjes së gjithsej depozitave diktohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare, kategori që dominon strukturën e gjithsej depozitave në sektorin bankar me pjesëmarrje prej 67-përqindësh në totalin e depozitave e të cilat në vitin 2020 shënuan rritje prej 7.3-përqindësh. Normat e interesit në kredi vazhduan trendin rënës, duke zbritur në 6.3 për qind nga 6.5 për qind sa ishin në periudhën e njëjtë të periudhës së kaluar, që tregon për lehtësim të vazhdueshëm të qasjes në financim bankar", u shpreh Mehmeti.

Ai ka bërë me dije se norma e kredive joperformuese shënoi një rritje të lehtë prej vetëm

2.7-përqindësh në tetor 2020, në krahasim me vitin e kaluar kur ishte 2.2 për qind, por mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione për humbje nga kreditë mbetet në nivele të larta prej 140-përqindësh, që dëshmon për nivele adekuate të provizioneve në sektorin bankar. "Sektori bankar vazhdon të ketë tregues të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 16.9-përqindësh në tetor 2020, krahasuar me 16.5 për qind në vitin paraprak, i cili vazhdon të mbetet dukshëm mbi nivelin minimal rregullativ prej 12-përqindësh. Me qëllim të mbajtjes së niveleve të shëndosha të kapitalit brenda sistemit bankar dhe për ta mbështetur ekonominë e Kosovës nëpërmjet kreditimit, BQK-ja ka marrë vendim për ta pezulluar shpërndarjen e dividendës nga ana e bankave

për vitin 2019 dhe 2020", ka deklaruar ai. Sipas Mehmetit, përveç sektorit bankar, rol të rëndësishëm për financimin kreditor të ekonomisë së Kosovës kanë edhe institucionet mikrofinanciare dhe ato financiare jobankare, të cilat kryesisht fokusohen në ofrimin e mikrokredive.

Në këtë konferencë guvernatori i BQK-së ka folur edhe për rolin e diasporës në kohën e pandemisë dhe rritjen e remitancave. "Vlera e remitancave të pranuar deri në tetor 2020 ishte 796.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.9-përqindësh. Për sa iu përket investimeve të huaja direkte, vlera e tyre deri në shtator 2020 arriti në 250.6 milionë euro, në krahasim me vlerën prej 216.4 milionë eurosh të regjistruar deri në shtator 2019", është shprehur Fehmi Mehmeti, guvernatori i BQK-së.

Komuniteti i biznesit kërkon që Kuvendi të mos shpërndahet para miratimit të buxhetit 2021



PRISHTINË, 22 DHJETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, zhvilloi të martën një takim virtual me komunitetin e biznesit në vend, të cilin e informoi në hollësi me masat e reja kundër Covid-19, që pritet të miratohen nga qeveria dhe të hyjnë në fuqi nga data 23 dhjetor 2020.

Komuniteti i biznesit ofroi

mbështetje për masat e reja kundër Covid-19 dhe insistoi që Kuvendi të mos shpërndahet pa e miratuar buxhetin 2021. Hoti i siguroi ata se është në komunikim të vazhdueshëm me grupet parlamentare dhe se po angazhohet maksimalisht që përbërja aktuale e Kuvendit ta miratojë buxhetin për vitin e ardhshëm, si dhe disa

marrëveshje ndërkombëtare që lidhen me buxhetin. Kryeministri Hoti dhe përfaqësuesit e komunitetit të biznesit u pajtuan se buxheti është parakusht për krijimin e pakos së re dhe zbatimin e masave për rimëkëmbje ekonomike, respektivisht mbështetje të bizneseve të prekura nga pandemia Covid-19.

Komuna e Drenasit sërish ndihmon familjet në nevojë

DRENAS, 22 DHJETOR (ER) - Komuna e Drenasit sërish po u del në ndihmë qytetarëve, duke u shpërndarë pako ushqimore dhe higjienike. Komuna përmes komisionit të caktuar enkas për këtë çështje dhe në bashkëpunim të ngushtë me administratorët e fshatrave, ka shpërndarë rreth 1 300 pako ushqimore dhe higjienike për familjet që kanë adresuar kërkesë për ndihmë tek administratorët. Pakot

janë shpërndarë te secila familje përmes administratorëve të vendbanimeve dhe komisionit, me qëllim që të evitohet grumbullimi i qytetarëve dhe shpërndarjes më efektive.

Kjo pako përfshinë 18 artikuj ushqimorë dhe produkte higjienike në vlerë prej afër 50 eurosh. Listat e përfituesve e pakos është hartuar nga administratorët e vendbanimeve, pasi ata e dinë

më së miri se cilat familje kanë nevojë për ndihmë në këtë situatë të pandemisë. Që nga muaji mars, Komuna e Drenasit së bashku edhe me donatorë të tjerë ka ndarë mbi 4 000 pako.

Kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, ka falënderuar administratorët, komisionin dhe gjithë stafin tjetër që janë angazhuar për ndarjen e këtyre pakove, duke theksuar se do të jetë afër qytetarëve gjithmonë.



Në Gjilan shpërndahen tabletë për nxënësit me aftësi të kufizuara

GJILAN, 21 DHJETOR (ER) - Në shkollën "Fetah Qerimi" të Verbiçës së Zhegocit janë shpërndarë tabletë për nxënësit me aftësi të kufizuara, me mbështetjen e organizatës "Save The Children".

Drejtori i Arsimit, Nazim Gagica, ka thënë se gjatë dhjetorit janë shpërndarë gjithsej 71 tabletë në disa shkolla të Gjilanit për fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilët do ta kenë më të lehtë qasjen në mësim online. "Presim këto ditë që nga UNICEF-i të shpërndahen edhe 65 tabletë, duke përbushur të gjitha kërkesat dhe nevojat me pajisje teknologjike për të gjithë nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollat e Gjilanit", ka thënë Gagica.


Ditë më parë organizata GIZ për këtë kategori dhuroi 175 tabletë në shkollën "Thimi Mitko".



Malisheva ndalon përdorimin e mjeteve piroteknike gjatë festive

MALISHEVË, 22 DHJETOR (ER) - Komuna e Malishevës ka marrë vendim për ndalimin e përdorimit të fishekzjarrëve dhe mjeteve të tjera piroteknike në territorin e kësaj komune. "Përdorimi i tyre lejohet vetëm një orë e gjysmë, përkatësisht më 31 dhjetor nga ora 23:00 deri më 1 janar në orën 00:30.

Përdorimi i tyre ndalohet në të gjitha hapësirat e banuara publike dhe private në tërë territorin e Komunës së Malishevës dhe për ekzekutimin e këtij vendimi, është autorizuar Drejtoria e Inspektoratit dhe organet e tjera të sigurisë", ka njoftuar Komuna e Malishevës.



Botohen të gjitha vendimet e Kuvendit të Komunës së Ferizajt për vitet 2018-2019

FERIZAJ, 22 DHJETOR (ER) - Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Ferizajt, Kristina Gashi-Bytyçi, i ka dorëzuar të parit të komunës, Agim Aliu, përmbledhjen me vendimet e Kuvendit të Komunës për periudhën 2018-2019. Kjo përmbledhje aktesh po bëhet për herë të parë, në funksion të transparencës,

dokumentimit më të mirë të punës së Kuvendit dhe qasjes më të lehtë për publikun në aktet e Kuvendit. Me këtë rast, kryesuesja e Kuvendit, Kristina Gashi-Bytyçi, ka thënë se ky dokument po realizohet për herë të parë dhe se këtë qasje do ta ketë edhe për periudha të tjera. "Libri i vendimmarrjes

transparente dhe qeverisjes së mirë, dokument i parë i Kuvendit të Komunës së Ferizajt të viteve 2018-2019, në të cilin janë të dëshmuara vendimet që ka marrë ky Kuvend gjatë kësaj periudhe, statutet, strategjitë dhe planet e veprimit dhe rregulloret të cilat janë në fuqi", ka thënë kryesuesja Bytyçi.



Komuna e Podujevës jep 46 lopë qumështore për blegtorët llapjanë



PODUJEVË, 22 DHJETOR (ER) - Komuna e Podujevës ka shpërndarë nga një lopë qumështore të racës "Hollshajtj" për 46 fermerë, përfitues të këtij subvencioni. Në kuadër të mbështetjes së

sektorit të blegtorisë, Komuna e Podujevës, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DPBZHR) ka shpërndarë 46 lopë qumështore të racës "Hollshajtj" për blegtorët llapjanë. Gjatë shpërndarjes së

lopëve ishte e pranishme nënkryetarja e Komunës së Podujevës, Marigona Lahu dhe drejtori i DPZHR-së, Vigan Salihu. Nënkryetarja Lahu ka uruar blegtorët përfitues dhe ka premtuar vazhdimin e

përkrahjes për bujqit llapjanë edhe në sektorë të tjerë. Ky subvencionim për blegtorë është realizuar në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të Komunës së Podujevës me organizatën OJQ "Mëshqerra".

Viti 2020 për Kosovën mbaroi aty ku filloi



Prof. Lisen BASHKURTI

Një rrotullim i plotë për Kosovën ndodhi në vitin 2020. Viti mbaroi aty ku filloi. Në fillim të vitit 2020 Kosova ishte e përfshirë në proceset politike postzgjedhore të vjeshtës, e cila votoi LV-në dhe Albin Kurtin për t'i udhëhequr bisedimet për formimin e koalicionit të ri qeveritar me LV-LDK. Bisedimet zgjatën relativisht shumë por, më në fund, konkluduan me krijimin e koalicionit midis LV-së dhe LDK-së, posaçërisht të kryesuar nga Albin Kurti dhe Vjosa Osmani. Kështu, fillimi i 2020-s e gjeti Kosovën me një qeveri të re, plot shpresa te qytetarët e Kosovës, sidomos te të rinjtë dhe intelektualët që bartnin më së shumti dëshpërimin për qeverisjet e dobëta, pa principe evropiane, pa profesionalitet dhe pa integritet moral. E shpallur si qeveri patriotike anti-korrupsion e antikrim, qeveria Kurti-Osmani po sillte entuziazëm të madh brenda Kosovës, por edhe në nivele rajonale dhe euroatlantike. Por, kjo situatë entuziazmi dhe pritshmërie nuk zgjati shumë, vetëm 50 ditë, pas të cilave çdo gjë u përmbys si me magji.

1. Legjitimiteti përballë makinacioneve politike

Prej shumë vitesh qeveritë në Kosovë kanë vënë në dyshim parimin e legjitimitetit, një prej parimeve themelore të qeverisjes në demokracinë liberale e që dominon sot demokracitë e konsoliduara kudo në botë. Disa analistë thonë se "sistemi zgjedhor në Kosovë nuk krijon mundësinë e një partie të vetme të fitojë zgjedhjet për krijimin e qeverisë pa koalicion". Për këtë ato rendisin edhe argumentin kushtetues se "në Kosovë çdo qeveri duhet të përfshijë edhe pakicat serbe në përbërjen e saj". Deri këtu pak a shumë kuptohet sistemi zgjedhor dhe kushtëzimi kushtetues për përfshirjen e pakicave në çdo koalicion qeveritar. Por ku është parë dhe ku është shkruar që të krijohen qeveri të parakushtëzuara nga koalicione absurde, të cilat

prodhojnë qeveri "me legjitimitet pakicash", ku parti shqiptare të nivelit të dytë dhe të tretë të marrin iniciativat e të krijojnë koalicione me makinacione politike, duke vënë në krye kryeministrat e tyre? Askund, vetëm në Kosovë. Kështu me makinacione të tilla u krijua qeveria Haradinaj dhe u emërua ai kryeministër nga një parti i nivelit të tretë. Po kështu, me makinacione politike u rrëzua qeveria Kurti dhe u zgjodh me një deputet të dënuar pa të drejtë vote qeveria Hoti, derisa Gjykata Kushtetuese e Kosovës e rrëzoi me vendimin e saj të datës 22 dhjetor 2020.

Prapa makinacioneve politike kanë qëndruar liderë politikë të Kosovës të 20 viteve të fundit, sidomos Thaçi dhe Mustafa, herë-herë edhe Haradinaj, të cilët e kanë konsideruar elektoratin e Kosovës si një makineri amorfe, të vdekur dhe pa kurrfarë ndikimi në zgjedhjen e organeve qeverisëse të Kosovës. Zëri i vetëm që u dëgjua fare pak në Kosovën e dy dekadave të fundit ishte ai i qytetarëve të Kosovës. Jashtë dhe pavarësisht vullnetit të tyre, kalkulimet dhe makinacionet politike të votave në Kuvendin e Kosovës e kanë devijuar vazhdimisht vullnetin e qytetarëve të Kosovës, duke prodhuar qeverisje jo legjitime, por makinacionesh politike.

2. Makinacionet politike me "petka diplomatike amerikane"

Më shqetësues në këtë lojë politike të paskrupullt ishte rasti i rrëzimit të Qeverisë Kurti dhe zgjedhja në vend të saj e qeverisë Hoti. Në këtë pazar politik, aspak legjitim dhe të ndershëm u përzje edhe diplomati amerikan, Grenell, i dërguari i presidentit Trump për bisedimet Kosovë-Serbi. Me një presion të dukshëm dhe të paprincipitë, aspak demokratik dhe diplomatik, Grenell së bashku me Thaçin dhe Mustafën dhe hiena jashtë Kosove, në Tiranë Rama dhe në Beograd Vuçiq, duke shfrytëzuar edhe paditurinë e presidentit Trump mbi situatën e kulisave Ballkanike, ndërtuan makinacionin politik më absurd në Kosovën e re. Kështu, u përdhosën demokracia, vota qytetare, legjitimiteti, sovraniteti, institucionalizmi, përballë

makinacioneve politike qëllimkeqe dhe shumë të rrezikshme për Kosovën dhe popullin e saj.

Në krye të fushatës përpara makinacionit për ndryshimin e qeverisë në Kosovë, u vendos slogani "me Kurtin apo me Amerikën", duke shfrytëzuar poshtërsisht respektin, mirënjohjen dhe besimin e lartë që populli i Kosovës ka për ShBA dhe kontributin e saj për Kosovën. Mbas makinacionit nën këtë slogan manipulativ ala Thaçi-Grenell-Vuçiq-Rama filloi aksioni diplomatik i tejnxituar për përpilimin e një marrëveshje Serbi-Kosovë që do të firmosej në Shtëpinë e Bardhe në prani të presidentit Trump.

Teksti i marrëveshjes e mënjanoi idenë e shkëmbimit, më saktë të ndryshimit të kufijve, sepse u kundërshtua fort dhe publikisht nga Gjermania dhe shumë vende të BE-së dhe të Ballkanit dhe mbështetej vetëm nga Vuçiq, Thaçi, Rama dhe Grenell. E çliruar nga ideja për shkëmbime territoriale dhe ndryshime kufijsh midis Serbisë dhe Kosovës, draft-marrëveshja, tanimë po bëhej si një përzierje e shumë marrëveshjeve të mëparshme midis Kosovës dhe Serbisë të inicuar nga BE-ja, të cilat Serbia kurrë nuk i zbatoi, me disa ide, projekte pragmatike ekonomiko-tregtare së bashku me idenë e Beogradit për minishengenin ballkanik. Minishengeni ballkanik nuk është produkt i konsultimit, dakordimit dhe mbështetjes nga 6 shtetet e Ballkanit Perëndimor, por vetëm nga trojka Vuçiq-Rama-Zaev dhe Grenell, me tendencë për t'iu imponuar Kosovës dhe vendeve të tjera.

Mirëpo, kur ceremonia po

përgatitej në Shtëpinë e Bardhe dhe tapeti i kuq po shtrohej për mysafirët nga Kosova dhe Serbia, ndodhi e papritura për dikë, por e pritura për shumëkënd, publikimi i akt-akuzës për Hashim Thaçin nga prokurori special në Hagë. Gjithçka u gris në skenën e teatrit që po luhej në mënyrën më dramatike e keqndjellëse për Kosovën. Thaçi anuloi vizitën dhe në vend të projektjalimit për në Shtëpinë e Bardhe, nisi përgatitjen e fjalës funebër për dorëheqjen e tij për t'u paraqitur në Hagë, pasuar edhe nga kolegët e tij udhëheqës të UÇK-së.

Në vendin e Thaçit në avionin drejt Uashingtonit hipi kryeministri Hoti, si pjesë e skenarit alternativ të Grenellit. Marrëveshja amalgamë u firmosur në mënyrë pompoze në sy të presidentit Trump. Kjo marrëveshje, më së shumti e perealizueshme në tërësinë e saj u bë jashtë syve të opinionit publik kosovar dhe jashtë çdo lloj gjithëpërfshirje institucionale të Kosovës. E prodhuar nga pak koka dhe e përpiluar me nxitim nga pak duar kjo marrëveshje amalgamë iu servir presidentit Trump, i cili ishte i etur për një arritje diplomatike përpara zgjedhjeve presidenciale pas dështimeve skandaloze në Korenë e Jugut, në Iran, në Venezuelë, në Kinë e në shumë iniciativa të tjera diplomatike pa rezultate. Duke u shprehur se marrëveshja "i jep fund luftës së përgjakur shekullore në Kosovë" dhe se një "komb mysliman njihet nga Izraeli dhe do të vendosë ambasaden e tij në Jerusalem", presidenti Trump demonstroi sesa konfuz, i paqartë dhe i painformuar ishte për Ballkanin, për Kosovën dhe Serbinë si dhe për identitetin

kulturor-fetar të shqiptarëve. Por këto arsye entuziazmi i 4 shtatorit do ishte shumë i shkurtër e jehona shumë e zbehtë.

Shumë kush nga aktorët lokal u përpoq të kapej mbas marrëveshjes së 4 shtatorit. Vuçiqi ishte i pari që u përpoq ta lansonte si fitore e diplomacisë Serbe dhe e rritjes së ndikimit të saj mbi Shtëpinë e Bardhe. Rama e mbështeti për shkak të përfshirjes në të idesë së minishengenit Ballkanik, të cilën kryeministri i Shqipërisë e mbështeti fort, duke e konsideruar në tregun e brendshëm politik si Eureka në politikës së tij të jashtme. Më zbehtë marrëveshjen e 4 shtatorit e mbështeti Kosova, e cila u vu përballë një teksti të shkruar anglisht, të cilin lypej ta firmoste pa zë dhe pa figurë.


3. Për Kosovën 2020 po mbaron atje ku filloi

Por situatat u përmbysën me fushatën presidenciale në ShBA. Trump humbi spektakulisht. Biden po hyn tanimë në Shtëpinë e Bardhe. Politika e jashtme e ShBA-së mbas një devijimi të paparishikueshëm katërvjeçar, po i rikthehet normalitetit të trasuar qysh pas Luftës së Dytë Botërore.

Aktorët qeveritar Ballkanik të mbetur në lojë prej vitesh, mjeshtër të kulisave, të makinacioneve politike dhe presioneve diplomatike ndodhen në panik. Të frustruar nga Bashkimi Evropian për procesin e ngecur të integritetit dhe të surprizuar nga ndryshimet në Shtëpinë e Bardhe, aktorët qeveritar Ballkanik të mbetur po i vënë gishtin kokës për sfidat që i presin.

Kambana e parë e sfidave për 2020 po bie në Kosovë. Gjykata Kushtetuese e rrëzoi qeverinë Hoti për palegjitimitet dhe shpalli kështu zgjedhjet e përgjithshme politike të parakohshme mbas 40 ditësh, pra në fillim të shkurtit 2021. Mbas këtyre zgjedhjeve që priten të sjellin ndryshimin e nisur dhe të lënë në mes në fillim të këtij viti 2020, do vijnë sfidat me zgjedhjet e përgjithshme në Shqipëri. Një reshuffle politik pritet të përfshijë qeverisjet në Ballkanin Perëndimor. Është koha e legjitimitetit qeverisë jashtë makinacioneve politike dhe lojërave diplomatike. Era e Shtëpisë së Bardhe po fryn dukshëm edhe mbi Ballkanin Perëndimor. Lavdi Zotit!





**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Basketbolli sjell ndeshje interesante në mesjavë

Sot (e mërkurë) zhvillohet derbi Prishtina - Rahoveci dhe Ylli - Trepça, kurse nesër (e enjte) takohen Peja - Ponte Prizreni dhe Vëllaznimi - Bashkimi



PRISHTINË, 22 DHJETOR - Në mesjavë do të zhvillohet xhiroja e dhjetë në Prince Caffè Superligë. Ndashje shumë interesante pritet të zhvillohet në mes të Sigal Prishtinës dhe Rahovecit, dy skuadra që janë përballur shumë në vitet e fundit, madje në finale të play-off-it dhe Superkupës. "Bardhekaltrit" hyjnë në këtë përballje pas fitores ndaj Trepçës, ndërsa "Vreshtarët" pas fitores ndaj Pejës. Prishtinasit kanë tri fitore dhe gjashtë humbje, kurse "Vreshtarët" shtatë fitore dhe dy humbje. Golden Eagle Ylli, pas dy

humbjeve radhazi, me trajnerin e ri turkun Fatih Emre Gezer, synon t'u rikthehet fitoreve, ku do të përballet me Trepçën, që ka dy fitore dhe shtatë humbje, kurse therandasiit kanë katër fitore e pesë humbje. Sfidë interesante shihet ajo ndërmjet Pejës dhe Ponte Prizrenit. Pejanët kanë shtatë fitore dhe dy humbje, kurse prizrenasit gjashtë fitore dhe tri humbje, andaj pritet të jetë një përballje shumë interesante në "Karagaçi". Vëllaznimi do të ndeshet me Bashkimin, ku të dyja skuadrat hyjnë për fitore.

Kuqezinjtë që janë rikthyer në Superligë, kanë tri fitore dhe gjashtë humbje, kurse prizrenasit kanë katër fitore dhe pesë humbje.

PRINCE CAFE SUPERLIGA - XHIROJA 10

Të mërkurën takohen:
15:00 Sigal Prishtina - Rahoveci
15:00 Golden Eagle Ylli - Trepça

Të enjten takohen:
15:00 Peja - Ponte Prizreni
15:00 Vëllaznimi - Bashkimi

KOK-u mbështet federatat sportive me 23 mijë euro

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik i Kosovës (KOK) ka marrë vendim t'i mbështesë Federatat Olimpikë dhe Joolimpikë të Kosovës pas vështirësive të krijuara nga përhapja e pandemisë Covid-19. Shuma e ndarë për federatat është rreth 23 mijë euro, të cilat do të ndahen nga 700 euro për Federatat Olimpikë dhe 500 për Federatat Joolimpikë të Kosovës. Për federatat olimpikë KOK-u ka fituar fonde nga Asociacioni i Komiteteve Olimpikë Kombëtare (ANOC), Komiteti Olimpik i Evropës (KOE) dhe Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (KON). Për të mos anashkaluar Federatat Joolimpikë, Bordi Ekzekutiv i



KOK-ut ka vendosur që këto federatat të mbështeten nga të hyrat e sponsorëve të KOK-ut. Gjatë këtij viti KOK ka mbështetur edhe sportistët

elitarë të sporteve të xhudos, boksit, mundjes dhe notit, bazuar në kërkesat e tyre për heqjen e shpenzimeve të përgatitjeve gjatë pandemisë.

SHKURT

Përforcohet KB Bashkimi

Skuadra e Bashkimit është përforcuar me basketbollistin amerikan K. J. Robinson, i cili luan në pozitën e organizatorit. "Robinsoni do t'i bashkohet të mërkurën ekipit dhe pritet të jetë i gatshëm për ndeshjen e ardhshme. Ai ka qenë pjesë e skuadrës amerikane nga NCAA, Omaha Mavericks, për të cilën ka luajtur që nga stinori 2016/17. Në stinorin e fundit me këtë skuadër ka pasur mesatare prej 15.2 pikëve, 2.7 asistimeve dhe 2.1 kërcimeve për ndeshje, duke pasur mesatarisht prej 32.1 minutash lojë në gjithsej 29 paraqitje", thuhet në njoftimin e KB Bashkimi.

Marku zbulon kundërshtarin e ardhshëm

Florian Marku dhe Rylan Charlton do të ballafaqohen mes vete në mbrëmjen e meçit kryesor mes David Avanesyan dhe Josh Kelly më 30 janar në një arenë që pritet të konfirmohet. Dueli do të transmetohet në "Sky Sports". Marku, me bilanc prej 7 fitoresh, asnjë humbje dhe një barazim, 5 duele të mbyllura me nokaut, do ta kërkojë kthimin te fitorja pas barazimit të dyshimtë më herët gjatë këtij muaji ndaj Jamie Stewart, edhe pse e rrëzoi kundërshtarin e tij në raundin e dytë. "Rylan ka thënë se do ta fshijë dyshemenë me Florian Markun. Më 30 janar nuk do ta lë në duart e gjyqtarëve. Faleminderit të gjithëve për mbështetjen!", ka shkruar Marku në "Facebook".

Ademi fiton çmimin e lojtarit më të mirë në Kroaci

Futbollisti shqiptar Arijan Ademi ka fituar çmimin e lojtarit më të mirë në Kroaci. Shqiptari ka fituar plot 66 pikë, duke mposhtur Mijo Caktas me 46 pikë dhe Franko Andrijaseviq & Kristijan Loviq që kishin nga 18 pikë. Ylli i Dinamo Zagrebit ka konfirmuar se ka pranuar çmimin duke postuar një foto në "Facebook". Ademi u shpreh i lumtur që fitoi çmimin e lojtarit më të mirë, derisa tha se ky çmim do të ketë vend të rëndësishëm në të gjitha arritjet e tij. "Mendoj se nuk ka nder më të madh kur të zgjedhin lojtar më të mirë, personat të cilët e bëjnë punën e njëjtë si ti. Ky trofe do të zë vend të rëndësishëm në mesin e të gjitha arritjeve të mia", u shpreh ai. Ademi përfaqëson Maqedoninë e Veriut me të cilët shkroi historinë duke u kualifikuar në Evropianin 2021.

Distria Krasniqi e zbret nga fronti Daria Bilodidin

Kampionia aktuale botërore e kategorisë -48 kg, Daria Bilodid, është rrëzuar nga fronti i më të mirës, nga xhudistja e Kosovës Distria Krasniqi. Dy herë fituesja e "IJF World Masters" do të jetë në kërkim të titullit të saj të tretë në Doha në muajin e ardhshëm, por tani për tani ajo mund ta shijojë mbretërimin e saj në kategorinë -48 kg. Sidomos pas një paraqitje të jashtëzakonshme në "Grand Slam" të Budapestit, i cili ishte turneu i parë i mbajtur që para pandemisë. Krasniqi është shprehur e gatshme për t'u rikthyer drejt garave, veçanërisht pas fitimit të medaljes së artë në "Paris Grand Slam" dhe pas marrjes së epitetit si më e mira e kategorisë -48 kg. Tani ajo nuk do të jetë e vetme, pasi që në kategoritë e lehta e ka edhe kampionen e botës në kategorinë -52 kg, Majlinda Kelmendin, dhe Kosova do t'i ketë shanset e mëdha për t'u kthyer me dy medalje të arta nga garat e ardhshme.

Rosberg: Schumacheri më i kompletuar se Hamiltoni

Wiesbaden, 22 dhjetor - Nico Rosberg është piloti që ka pasur mundësi t'i ketë shokë skuadre dy pilotët me më shumë tituj kampionë bote në Formula 1: Michael Schumacher dhe Lewis

Hamilton. Përmes një interviste për "Frankfurter Allgemeine Zeitung", ish-kampioni i botës në vitin 2016, et për dy pilotët dhe bën dallimin mes tyre. "Pa asnjë pikë dyshimi që Michael Schumacher është një pilot më

i kompletuar, më i kompletuari nga të gjithë. Ishte gjithnjë i motivuar për t'u përmirësuar, jo vetëm për vete por edhe për skuadrën ku garonte", ka thënë Rosberg. "Nëse Schumacher është nga një planet tjetër për

sa i përket faktit që ishte një pilot i kompletuar, Hamiltoni ka një talent natyral që nuk e ka njeri tjetër. Sapo ulet në një makinë ai bëhet i shpejtë dhe kjo është mahnitëse", ka deklaruar Rosberg.



Dënohen Prishtina, Munishi dhe Duro



PRISHTINE, 22 DHJETOR - Komisioni disiplinor i shkallës së parë i ka shqyrtuar procedurat e hapura nga mbledhja e kaluar si dhe inicimet e filluara disiplinore nga Komisioni i Garave dhe për të njëjtat, duke iu referuar raporteve zyrtare konform dispozitave të Rregullores Disiplinore, ka marrë vendime lidhur me klubin Prishtina, trajnerin e Ballkanit,

Ismet Munishi dhe trajnerin e Feronikelit, Klodian Duro. Skuadra e Prishtinës është dënuar me 1 000.00 euro për shkak se ka bërë lëshim në organizimin e ndeshjes kundër Ballkanit ku një numër i shikuesve ishte futur në tribunat e stadiumit në kundërshtim me rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë, IKShPK-së dhe FFK-së. Ndaj Munishit ishte

inicuar procedurë disiplinore për mosrespektimin e kodit të sjelljes lidhur me deklaratat pas ndeshjes ndaj Prishtinës, ndërsa për këtë është dënuar me gjobë prej 500.00 eurove. Ndërsa trajneri i "Niklit", Klodian Duro, dënohet me 300.00 euro për mosrespektim të kodit të mirësjelljes sportive në media pas përfundimit të ndeshjes Llapi - Feronikeli.

Shtyrja rrit koston e Olimpiadës



TOKIO, 22 DHJETOR - Shtyrja e Lojërave Olimpikë "Tokio 2020" për verën e ardhshme ka rritur me 22 % koston e kësaj olimpiade. Ka qenë ky informacioni që kanë dhënë të martën organizatorët e ngjarjes më të madhe olimpikë. Kostoja e parashikuar për Olimpiadën ishte 12.6 miliardë dollarë,

ndërkohë që organizimi i saj verën e ardhshme ka bërë që kostoja të shkojë në 15.4 miliardë dollarë. Shuma prej 2.8 miliardë dollarësh ka rënduar jo pak buxhetin. Shtyrja e Olimpiadës erdhi si pasojë e pandemisë Covid-19 dhe kjo shtesë e buxhetit do të përdoret pikërisht për menaxhimin e

pandemisë. Por një pjesë e mirë e shumës shtesë ka ardhur edhe si pasojë e mosrespektimit të kontratave. Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC) u shpreh se do të japë 1.3 miliardë dollarë të kësaj shume shtesë, për t'i mbështetur organizatorët. Lojërat Olimpikë do të nisnin më 23 korrik 2021.

SHKURT

Newcasteli interesohet për Bardhin

Skuadra e Premierë Ligës, Newcastle, ka shprehur interesim për ta transferuar mesfushorin e Maqedonisë së Veriut, Enis Bardhi. Kështu kanë raportuar të hënën mediumet në Angli. Bardhi është pjesë e Levantes së Spanjës dhe me këtë skuadër ka kontratë deri në vitin 2022. Ai së fundi është kthyer nga lëndimi që e la jashtë fushës që nga 8 nëntori i këtij viti. Bardhi i mungoi Levantes në pesë ndeshjet e fundit në kampionatin spanjoll.

Casillasi rikthehet te Reali

Ka qenë vetë klubi i Real Madridit që nëpërmjet një njoftimi në faqen zyrtare, ka konfirmuar lajmin se Iker Casillasi rikthehet në klubin ku fitoi shumë tituj. "Iker Casillas është një legjendë e Real Madridit. Ai përfaqëson vlerat e klubit tonë dhe është portieri më i mirë në historinë tonë", shkruhet në njoftimin e klubit. Casillasi fitoi 19 tituj gjatë 25 vjetëve që ai mbrojti veshur fanellën e Realit, 3 Kupa Evropiane, 3 Kupa Botërore Klubes, 2 Super Kupa Evropiane, 5 Liga, 2 Kupa të Mbretit dhe 4 Super Kupa Spanjolle. Në Portugali, me Porton, ai fitoi 2 Liga, 1 Kupë dhe 1 Super Kupë.

Messi: Pandemia e ka ndryshuar futbollin

Lionel Messi mori nga gazeta prestigjioze "Marca" trofeun "Pichichi", që i jepet golashënuesit më të mirë të kampionatit spanjoll. "Pleshti" e fitoi këtë çmim për herë të shtatë në karrierë, pasi e mbylli La Ligan 2019-2020 me 25 gola. "Ne do të përpiqemi të fitojmë gjithçka siç kemi bërë gjithmonë në këtë klub. Ne po rritemi pak nga pak. Është e vërtetë që ne nuk duhet të kishim lënë kaq shumë pikë rrugës. Tani gjëja e rëndësishme është që të marrim një seri rezultatesh të mira për të arritur në majë sa më shpejt të jetë e mundur", ka thënë Messi, i cili foli edhe për vështirësitë që kanë lindur prej koronavirusit. "Me pandeminë të gjitha ndeshjet janë të vështira. E vërteta është që futbollin ka ndryshuar shumë dhe është e vështirë për këdo. Është e tmerrshme të luash pa tifozë. Ashtë një ndjenjë shumë e keqe. Është si stërvitje dhe kërkon shumë kohë për të hyrë në lojë. Pandemia ka ndryshuar të gjithë futbollin për keq. Ne e shohim atë në çdo ndeshje. Shpresojmë që së shpejti të luajmë me tifozët në stadione", ka deklaruar Messi.

Marseille nuk heq dorë nga transferimi i Giroudit

Olympique Marseille ende do që ta transferojë sulmuesin e Chelseas, Olivier Giroud, sipas raportimeve nga Le10Sport. Gjiganti francez është në kërkim të një sulmuesi dhe në janar do të lëshohen në një ofensivë për të gjetur një të rangut më të lartë. Një herë kampionët e Evropës e kanë kërkuar ish-yllin e Arsenalit edhe në të kaluarën dhe, si duket, kjo dëshirë do të shndërrohet në tentativë edhe gjatë afatit kalimtar të janarit.

Juve ofron 10 milionë euro për Milikun

Arkadiusz Milik është jashtë planeve të Napolit teksa këtë sezon nuk është grumbulluar dhe aktivizuar në asnjë ndeshje. Të Kaltrit mund të heqin dorë nga polaku që në muajin janar, për të mos humbur pa asnjë euro në fund të sezonit, kur i përfundon kontrata. Vlera e kartonit të tij është 18 milionë euro por, duke parë situatën, Napoli mund të heqë dorë prej tij për 10 milionë euro. Kjo marrëveshje mund t'i kënaqë të gjitha palët. Juventus është gati ta paguajë këtë shumë, ndërkohë që mund t'i ofrojë edhe një kontratë prej 4 milionë eurosh në sezon. "Bardhezinjtë" janë në kërkim të një sulmuesi të parë, pasi për momentin kanë vetëm Moratën, i cili nuk mund të përballojë gjithë sezonin që është e mbushur me ndeshje. Milik është zgjedhja e përkryer, edhe pse do t'i duhet të paktën dy muaj për ta rigjetur formën e tij më të mirë.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se N.N.T.“ PRO-ING”, adresa Avni Shabani, Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik: 810627036 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa N.N.T.“ PRO-ING”, adresa Avni Shabani Mitrovicë, donelo odluku o prestani rada sa nr. Unik: 810627036, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the N.N.T.“ PRO-ING”, adresa Avni Shabani, Mitrovicë has come to the decision to quit its nr. Unik: 810627036 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

**SWISS
TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kiesłowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zyber Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike “Dekalogu” të regjisorit Krzysztof Kiesłowski, i ndërthurur me një egzgjenezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlihd temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kiesłowski, “Dekalogu” i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet “Dekalogu” i Kiesłowski dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se ‘thjeshtësia është madhështi’.

Daut Dauti

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚŁOWSKI



AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kiesłowski



ÇMIMI: 5.99 €

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Dardana Invest" Sh.p.k. Poliqkë, Kamenicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e parkut energjetik me erë "Kitka 2" në Hogosht, Poliqkë, Lisockë komuna e Kamenicës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 20.01.2021 në ora 10:00 në objektet e "Air Energy" në fshatin Poliqkë lagjja "Kikë" komuna e Kamenicës do të organizohet debat publik nga kompania "Dardana Invest" Sh.p.k. Poliqkë, Kamenicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e parkut energjetik me erë "Kitka 2" në Hogosht, Poliqkë, Lisockë komuna e Kamenicës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/8299721574?pwd=MUVGRINTdFU2eVRK NUNkSWtNaWE5dz09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

"Dardana Invest" Sh.p.k.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Mars Plastik Kosova" SH.P.K. Gjilan me pronar Gjengiz Nasufi, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811188102 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Mars Plastik Kosova" D.O.O. Gjilan, Gjengiz Nasufi donelo odluku o prestani rada sa nr. 811188102, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Mars Plastik Kosova" L.L.C. Gjilan Gjengiz Nasufi, has come to the decision to quit its nr. 811369314 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Ref. Nr. 2784

Pejë, 21.12.2020

SHËNIM ZYRTAR

Njoftohen kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin ref. nr. 2339/20, të dt. 18.11.2020, në pozitën një mësimdhënës për lëndët: Historia e Shtetit dhe së Drejtës (Historia e Institucioneve), E Drejta Romake, Retorika dhe Shprehjet Juridike në Fakultetin Juridik të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, se Senati i Universitetit ka nxjerrë vendim ref. nr. 2746/20, të dt. 16.12.2020, sipas të cilit kjo pozitë anulohet, pasi që lënda Historia e Shtetit dhe së Drejtës (Historia e Institucioneve) e propozuar nga Këshilli i Fakultetit Juridik sipas propozimit ref. nr. 2290/20, të dt. 16.11.2020, nuk ekziston në planprogramin e akredituar të Fakultetit Juridik 2019 – 2022.

Adresa: Rr. "UÇK-së" 30000 Pejë
www.unhz.eu ; E-mail: info@unhz.eu ; Tel. : +381/39/423 270

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ "Dardania Post" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810067729.
- ▶ "Koci-Gallery" B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70398092 si dhe me nr. fis. 600027636.
- ▶ N.Sh.T ADAM & EVA B.I, shpall të pavlefshëm certifikatën e numrit të biznesit: 70629011, të lëshuar në Prishtinë.
- ▶ Adelina Xharrahu, e diplomuar në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", shpall të pavlefshme diplomën e studimeve bachelor.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

